

AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ Keit.Reina ” sh.p.k.

Sot ne daten **08.11.2024** , un ortaku themelues :

Z. Nikolla Vasku Cirillo , shtetas shqiptar , i datelindjes **18.11.1978**, atesia **Kristo** , lindur ne **Mizë , Lushnje** , banues ne rruga **Teodor Rupi ND. 32; H. 1 , Durres ; 2004**, i pajisur me pashaporte me nr **BC5969134** , nr personal **H81118012S** , leshuar me date **16.01.2020** , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Ne baze te ligjit nr.9901 date **14.04.2008** “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ligjit nr.9723 date **03.05.2007** “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” , kam vendosur te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar “ **Keit.Reina ” sh.p.k.**

NENI 1 EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria do te quhet “ **Keit Reina ” sh.p.k** dhe eshte person juridik shqiptar.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas neneve te ketij statuti dhe Ligjit 9901, date **14.04.2008**, si edhe te ligjit per QKR-en.

NENI 2 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen : **DURRES Lagja nr. 17, Rruga Dalip Peza, Pallati 2129, Kati i pare**

Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 3 OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kryej aktivitet si me poshte :

Prodhimin dhe tregtimin e thaseve me material polyester , import eksportin e tyre . Fasoneri

NENI 4 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali i shoqerise “ **Keit.Reina ” sh.p.k.** eshte **1.000 (njemije) leke**

Ky kapital perbehet nga **1- nje kuote** dhe zoterohet nga :

Z. Nikolla Vasku Cirillo qe zoteron **100 %** te vleres te kapitalit te shoqerise te barabarta me vleren **1.000 leke** .



NENI 5
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

NENI 6
ORGANET E SHOQERISE

-Asambleja e pergjithshme

-Administratoret

ASAMBLEJA E PERGJTHSHME

Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhteme :

-Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

-Ndryshimin e Statutit.

-Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

-Emerimin dhe shkarkimin e likujduesave dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

-Percaktimin e shperblimeve per administratorin,likujduesin dhe ekspertin kontabel.

-Mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga aministratoret, perfshire pergaditjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

-Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

-Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre.

-Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.

-Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

-Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

-Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti

ADMINISTRATORET

Administrator i shoqerise do te jete Z.Nikolla Vasku Cirillo , shtetas shqiptar , i datelindjes 18.11.1978, atesia Kristo , lindur ne Mizë , Lushnje , banues ne rruga Teodor Rupi ND. 32; H. 1 , Durres ; 2004, i pajisur me pashaporte me nr BC5969134 , nr personal H81118012S , leshuar me date 16.01.2020 i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte ripërteritje.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo moment nga asambleja,me shumice te thjeshte te votave,me kusht qe ne mbledhje te marrin pjese ortaket me te drejte vote,qe zoterojne me shume se 51 % te kuotave.

Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.



NENI 7
SHPERNDARJA E FITIMIT VJETOR TE SHOQERISE

Pjesa e fitimit qe i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor te deklaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise, vendoset te shperndahet nga asambleja e pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme ka kompetence t'u shperndaje ortakeve pjesen e fitimit ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Po ashtu , Asambleja e Pergjithshme mund te vendose qe nje pjese e fitimit vjetor te mos u shperndahet ortakeve, por keto shuma te perdoren per zmadhimin e kapitalit fillestar apo per qellime te tjera, te cilat ajo i konsideron te dobishme per shoqerine.

NENI 8
PRISHJA E SHOQERISE

Prishja e shoqerise

Shoqeria priset :

a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.

b) me vendim te asamblese se pergjithshme

c) me hapjen e procedurave te falimentimit

c) ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perpurhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 per "QKR"

d) me vendim te gjykates

dh) per arsye te tjera te parashikuara ne statut

NENI 9
LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te likujdimit te shoqerise, Asambleja e Pergjithshme emeron nje likujdator, i cili administron shoqerine deri ne mbylljen e procesit te likujdimit.

Me vendim e posacem te Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumice te kualifikuar, pasi jane shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditoreve te shoqerise, likujdatori shperndan pjesen e mbetur te pasurise se shoqerise ndermjet ortakeve. Kjo shperndarje e fundit behet ne raport me vleren e kapitalit te regjistruar, qe kuotat e secilit ortak perfaqesojne.

Likujduesit duhet te ftojne kreditorin per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Shoqeria e publikon dy here keto njoftime, me nje interval prej 30 ditesh, ne faqen e saj te internetit, si dhe ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ne njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet te depozitohen brenda 30 diteve nga data e njoftimit te fundit.

NENI 10
PERFUNDIMI I LIKUJDIMIT



Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura,likujduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likujdimit dhe kerkon crregjistrimin e shoqerise.

Veprimtaria e likujduesit nuk mund te kundershohet pas crregjistrimit te shoqerise nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

NENI 11
MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim.

Ne rast te kundert, ortaket themelues do ti drejtohen Gjykates kompetente per zgjidhje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

“ Keit.Reina ” sh.p.k.

Nikolla Vasku Cirillo

Nikolla Vasku Cirillo

